



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 06.03.2025

Nr: 241

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 54 ID, DATË 26.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 06.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht nxjerrja e akteve para fushatës zgjedhore që synojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë

BAZA LIGJORE: Nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 26.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në protokoll, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 54 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve në media se Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit është mbledhur më 19 shkurt, për të miratuar një listë të gjatë me leje. Në sy mes vendimeve bien disa ndërtime me disa objekte dhjetëra kate të vendosura kryesisht në Tiranë, Durrës, Vlorë apo Lezhë.

Data: 06.03.2025

Nr: 241
Ora: 12:00



“Për mosfillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 54 ID, datë 26.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

Në këtë mbledhje, KKTU ka miratuar 57 leje, në favor të subjekteve të caktuara të cilat zhvillojnë aktivitetin në fushën e ndërtimit dhe njëkohësisht ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Selenicë, Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Belsh dhe Planin e Detajuar Qendror “Durana Tech Park”.

Partia Demokratike ngre shqetësimin dhe dyshimin se miratimi i këtyre akteve të cilat i drejtohen një kategorie të caktuar subjektësh/ përfituesish para fushatës zgjedhore është një tentativë nga ana e këtij institucioni për të ndikuar dhe përfutuar mbështetjen politike të subjekteve përfituese në prag të zgjedhjeve”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillim të procedurës administrative për denoncimin nr. 54 ID, datë 26.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI